
Lushnje, më 18 /03/2021

KALLËZIM PENAL

KALLZUES:

ME OBJEKT: Kallëzim i veprës penale , Neni 187 “ Falsifikimi dokumenteve shkollore”, Neni 190 “Falsifikimi vulave stampave dhe formularëve”, Neni 328 “ Dhënia e premtimeve dhe shpërblimeve”.

KUNDER:

[REDAKTUAR] me detyrë Drejtor [REDAKTUAR]
[REDAKTUAR] Punonjëse e Zyrës së Gjendjes Civile
Bashkia Lushnjë.

DREJTUAR:

PROKURORISË SPAK TIRANË

I nderuar Z. Prokuror,

Bazuar në nenet 280, 283 dhe 75/a të K.Pr.Penale, si dhe neneve 187,190 dhe 328 të Kodit Penal, parashtrojmë këtë kallzim penal për veprat penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

I. LIGJI I APLIKUESHEM

1.1. Kodi i Procedurës Penale, në nenet 280, 283 dhe 75/a parashikon se:

Neni 280

Marrja dijani për veprën penale

Prokurori dhe policia marrin dijeni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.